



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Bordi i Administrimit

Nr. Prot

Shkodër, më 08. 01 .2019



V E N D I M

Nr. 10/, datë 08. 01 . 2019

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.212 DATË 07.06.2018 PËR TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, VITI AKADEMIK 2018- 2019”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 pika 3 germa ç), neni 6 pika 30, neni nr. 49, VKM nr. 288 datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar me VKM nr. 723 datë 06.12.2018 si dhe me VKM nr.778 datë 26.12.2018, vendimit nr. 5/1 datë 08.01.2019 të senatit akademik, Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në mbledhjen e tij të 08.01.2019,

VENDOSI

1. Tarifa vjetore e shkollimit në programet e ciklit të parë të studimeve, bachelor (program të parë e program të dytë studimi), sistemi me kohë të plotë, viti akademik 2018- 2019 e miratuar me vendimin nr. 212 datë 07.06.2018 do të paguhet në masën 50% nga studentët sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesa tjetër do të rimbursohet me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar.
2. Shfuqizimin e pikës 3 të vendimin nr. 212 datë 07.06.2018 të Bordit të Administrimit.
3. Ngarkohet Administratori i USH-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

EDUARD NDRECA

